



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës – Gjakovë

01,nr. 463/02-33027/2018

Dt. 04.12.2018

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjin për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 5 dhe nenin 9 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, nenin 4 dhe 5 të Rregullores së QKR-së nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 04.12.2018, pas diskutimit lidhur me pikën e 3-të, të rendit të ditës: Propozimi për zgjatjen e afatit të Shfrytëzimit të hapësirave të Pallatit të Kulturës nga Kompania “Cacoo” SH.P.K, nga 10 në 15 vite, e miratoi këtë:

V E N D I M

Për zgjatjen e afatit të shfrytëzimit të pronës komunale

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale për zgjatjen e afatit të shfrytëzimit të pronës komunale Kompanisë “Cacoo” SH.P.K, në hapësirat e Pallatit të Kulturës .
2. I zgjatët afati i shfrytëzimit të pronës Komunale nga 10 në 15 vite, Kompanisë “Cacoo” SH.P.K me adresë në rrugën “Nëna Terezë” pa nr. në Gjakovë i përcaktuar në kontratën me numër të protokollit 01-463/01-21147 e datës 04.10.2017 për Shfrytëzimin e pronës komunale .
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e komunës.
4. **Vendimi iu dërgohet:**
 - Kryetarit të Komunës, z. Ardian Gjini .
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë .
 - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës .
 - Arkivit.



Kryetari i Kuvendit të Komunës

Anton Shala